

STAFI POLITIK / KABINETI I KRYEMINISTRIT

ADNOR SHAMETI

Z. Shameti shërben si Këshilltar ligjor në zyrën e Kryeministrit të Shqipërisë, që prej shtatorit të vitit 2021. Në vitin 2017 zgjidhet deputet i Kuvendit të Shqipërisë në Legjislaturën e IX, duke përfaqësuar qarkun e Beratit. Z. Shameti ka përfunduar me medalje ari studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Dega Juridik, Tiranë. (1991 - 1995) dhe punësohet menjëherë pas studimeve si pedagog pranë këtij fakulteti. Që prej vitit 1995 e në vazhdim, ushtron profesionin e avokatit dhe njëherazi është anëtar i Dhomës së Avokatisë, Tiranë. Prej vitit 2006 deri në vitin 2014 ka qenë drejtues në një universitet privat. Në vitin 2008, z. Shameti mbron gradën Doktor i Shkencave në Drejtësi. Ai ka kualifikime të shumta në vende të BE-së dhe SHBA-së si dhe pjesëmarrje në konferenca të shumta, brenda dhe jashtë vendit.

Z. Shameti ka kryer specializim në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Leidenit, Hollandë në vitet 1993-1994. Z. Shameti është autori i parë dhe bashkëautor në botime dhe artikuj shkencor të publikuar, brenda dhe jashtë vendit. Ai zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe atë italiane.

KEVIN BUFI

Kevin Bufi mban pozicionin e këshilltarit në Kabinetin e Kryeministrit.

Z. Bufi ka një eksperiencë disavjeçare në sektorin privat për ofrimin e shërbimeve ligjore, ku ka zhvilluar aftësitë e tij në hulumtim ligjor, konsulencë, hartim të kontratave dhe përfaqësim gjyqësor në firma të njohura ligjore vendase. Prej vitit 2017, është anëtar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Në vitin 2021 është angazhuar në sektorin publik ku ka punuar pranë Avokaturës së Shtetit, duke kontribuar në përgatitjen e strategjisë së mbrojtjes për çështje gjyqësore ndërkombëtare. Në vijim, ka shërbyer si Këshilltar i Kryenegociatorit të Shqipërisë për Negociatat e Anëtarësimit me Bashkimin Evropian, duke luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e progresit të disa kapitujve të integritetit dhe në sigurimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të BE-së, si pjesë e ekipit që kontribuoi në hapjen e negociatave të anëtarësimit. Kevin ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, ku është diplomuar me rezultate të larta në Fakultetin e Drejtësisë. Ai ka vijuar studimet e thelluara në fushën e së drejtës në disa prej universiteteve më prestigjioze në Evropë, duke u diplomuar me rezultate të larta në Zgjidhje të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Arbitrazh pranë Universitetit të Leidenit në Hollandë dhe më pas, në të Drejtë Biznesi Ndërkombëtare dhe Evropiane në Universitetin Katolik të Leuvenit në Belgjikë.

Përtej karrierës profesionale, është i përfshirë në sferën akademike duke u angazhuar pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës si profesor i jashtëm në departamentin e së drejtës publike. Ai ka marrë pjesë gjithashtu në iniciativa të shoqërisë civile dhe programe trajnimi, ndër të cilat në të Drejtë Ndërkombëtare Humanitare pranë Qendrës Grotius në Hagë, klinika ligjore organizuar nga Universiteti i Leuven, Erasmus +, Konferenca Model Nato (pjesë e ekipit fitues dhe më pas gjyqtar) etj.

Kevin zotëron njohuri të thelluara të gjuhës angleze, italiane dhe greke.

ELORA KOKALARI

Znj. Elora Kokalari mban postin e këshilltarit në Kabinetin e Kryeministrit dhe drejton Njësinë e Koordinimit me Qeverinë. Ajo vjen nga një eksperiencë e gjatë në qeverisje dhe menaxhim projektesh.

Më parë, znj. Kokalari ka shërbyer si drejtoreshë e kabinetit të ministrit të Brendshëm, ku ka dhënë kontribut në implementimin e politikave në sigurinë publike, luftën kundër krimit të organizuar dhe për pushtetin vendor. Eksperienca e saj në qeverisje shtrihet në drejtimin e Njesisë së Jetësimit të Prioriteteve pranë Kryeministrit dhe me parë koordinimin ndërsektorial në zbatimin e prioritetit të shërbimeve publike. Ajo ka nisur karrierën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka shërbyer si analiste biznesi pranë Quebecor World, Chicagoe, më pas si specialiste marketingu pranë Fondacionit Chaffey College” në Kaliforni. Me kthimin në Shqipëri, ajo drejtoi sektorin e marketingut pranë “Infosoft Systems e, më pas, punoi në sektorin e arsimit të lartë, ku krahas mësimdhënies, ajo punoi në zyrën e zhvillimit të biznesit pranë universitetit “Marin Barleti”.

Znj. Kokalari mban diplomën “Bachelor of Science pranë California State Polytechnic University, Pomona, në degët “Biznes ndërkombëtar” dhe “Menaxhim marketingu”. Ajo, gjithashtu, mban diplomë të asociuar në Administrim Biznesi nga Chaffey College në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

BESION HASAJ

Z. Besion Hasaj shërben si analist në kabinetin e Kryeministrit, në fushën e energjisë dhe infrastrukturës. Gjatë kësaj kohe z. Hasaj ka ndjekur zbatimin e politikave në fushën e energjisë, infrastrukturës, burimeve natyrore, transportit rrugor, transportit detar si edhe reformimin e sektorit të ujësjellës dhe kanalizimeve. Z. Hasaj ka eksperiencë mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Më parë ka shërbyer si Drejtues në Drejtorinë e Financës dhe Tregtisë në shoqërinë aksionare me kapital 100 % shtetëror “Illyrian Guard” për një periudhë 2 vjeçare. Në sektorin privat, angazhimi i tij ka qënë në fushën e tregtisë dhe menaxhimit financiar në pozicionin specialist dhe menaxher në sektorin e automobilëve, energjisë dhe ndërtimit.

Z. Hasaj mban diplomën “DND” në Fakultetin e Ekonomisë dega Financë, në Universitetin e Tiranës. Gjithashtu z. Hasaj ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e financave, kontabilitetit dhe atyre kompjuterike.

AIDA HASMETA

Znj. Aida Hasmeta shërben si analist i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës prej vitit 2018. Gjatë kësaj periudhe, znj. Hasmeta ka ndjekur zbatimin e politikave kryesore në fushën e shëndetësisë, çështjeve sociale, shërbimeve publike dhe digjitalizimin. Mëherët, ka shërbyer si koordinatore pranë kësaj njësie për çështjet e

shëndetësisë, arsimit dhe kulturës.

Znj. Hasmeta vjen nga një eksperiencë e gjatë në monitorimin dhe hartimin e politikave, si edhe të dokumenteve strategjike. Ajo ka nisur karrierën e saj në Ministrinë e Shëndetësisë ku ka shërbyer si specialiste e monitorimit dhe vlerësimit të informacionit shëndetësor dhe është angazhuar në grupet e punës për monitorimin e programeve të qeverisë, hartimin e strategjisë së shëndetësisë, planit të veprimit të promociionit shëndetësor, koordinimin sektorial dhe ndërsektorial për konsultimin publik, monitorimin e fëmijëve në rrezik braktisjeje shkolle, zbatimin e akademisë së shëndetit në shkolla etj. Më parë është angazhuar me organizata joqeveritare me projekte në çështjet sociale dhe të arsimit.

Znj. Hasmeta është diplomuar në Universitetin e Mjekësisë Tiranë për “Mjekësi të përgjithshme”. Gjithashtu, ajo ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e politikave shëndetësore të fokusuara në mbulimin shëndetësor universal, të ofruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik Zvicëran.

ALKIDA THANA

Znj. Alkida Thana shërben si analist në Kabinetin e Kryeministrit, në Njësinë e Koordinimit me Qeverinë. Ajo vjen nga një eksperiencë 22-vjeçare në fushën e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjes civile dhe sigurisë kombëtare. Në angazhimet e mëparshme, znj. Thana ka shërbyer si analist i informacionit kriminal për krimin e organizuar dhe korrupsionin në Policinë e Shtetit, organizimin e punës për shpalljen, ndjekjen, organizimin për kapjen e personave të kërkuar nga drejtësia dhe si oficer i Policisë Gjyqësore.

Znj. Thana mban diplomën “Bachelor” në Akademinë e Rendit Publik, Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë nga Fakulteti i Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, licencë për ndërmjetësim dhe licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit. Znj. Thana ka kryer dhe një sërë kualifikimesh profesionale nga institucione të ndryshme, si EUROPOL, PAMECA, UN, Akademia Diplomatike Shqiptare, ICITAP etj, në fushën e analizës dhe teknikës analitike, përpunimit të informacionit dhe përdorimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit kriminal, ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, vlerësimit të kërcënimit nga krimi i organizuar dhe krimet serioze (SOCTA), ndërtimit të institucioneve për anëtarësimin në BE, përafrimin e legjislacionit, dhunën në familje, lidërshipi dhe menaxhimin e krizave etj.

ARDIT DRENOVA

Z. Ardit Drenova shërben si analist pranë Kabinetit të Kryeministrit, Njësia e Koordinimit me Qeverinë.

Z. Drenova vjen nga një eksperience mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Më parë ka shërbyer si shef i financës dhe menaxhimit të riskut në OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit), dhe si audit i lartë pranë KPMG Shqipëri.

Z. Drenova ka përfunduar studimet universitare në nivelin “Bachelor” pranë American University in Bulgaria, Blagoevgrad, në fushën ekonomi, me specializim në matematikë dhe

shkenca kompjuterike.

ANDI MAZI

Z. Andi Mazi shërben si analist në Kabinetin Kryeministrit, në Njësinë e Koordinimit me Qeverinë. Ai vjen nga një eksperiencë e gjatë në qeverisje dhe hartim e monitorim politikash dhe strategjish. Më parë, z. Mazi ka shërbyer si analist në Njësinë e Jetësimit të Prioriteteve, ku ka siguruar ndjekjen dhe zbatimin e politikave për formalizimin e tokës bujqësore, një nga prioritetet e qeverisë. Eksperienca e tij nëqeverisje përfshin koordinimin ndërsektorial në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe strategjive të lidhura me fushën e mirëqeverisjes. Gjithashtu, ai ka shërbyer si menaxher për projektin “Zhvillimi i sistemit të planifikimit të integruar të politikave” (IPSIS) dhe si Koordinator Kombëtar për Konsultimin Publik. Ai ka nisur karrierën e tij në Ministrinë e Integritimit Evropian ku ka shërbyer si përgjegjës i sektorit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut dhe më parë si specialist në të njëjtin sektor.

Z. Mazi zotëron një diplomë LL.M në të Drejtën Europiane nga Universiteti i Maastricht në Holandë dhe një diplomë “Bachelor” nga universiteti “Luarasi” në drejtësi. Ai, gjithashtu, ka kryer trajnime të ndryshme në fushën e hartimit të legjislacionit dhe sigurisë ndërkombëtare.

INA MEMISHAHI

Znj. Ina Memishahi shërben si analist pranë Kabinetit të Kryeministrit. Më parë, znj. Memishahi ka shërbyer si ndihmës i Kryeministrit, ku ka siguruar administrimin dhe procedimin e korrespondencës ditore pranë Kabinetit të Kryeministrit. Ajo ka një përvojë të konsiderueshme pune në sektorin privat dhe publik, si: sekretare ndihmëse, sekretare, sekretare e parë, kryesekretare dhe asistente dekanit në institucionet e arsimit të lartë. Znj. Memishahi ka punuar si asistente noteri, si dhe sekretare e Kryeministrit e asistente e drejtorit të Kabinetit të Kryeministrit.

Znj. Memishahi i ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Histori-Filologjisë, dega gjeografi, dhe mban titullin specialist i gjeografisë. Gjithashtu, znj. Memishahi ka kryer studimet “Master në administrim publik”. Ajo ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën mjedisore, për mbetjet e riciklueshme, për statistikën, për hartimin e standardeve profesionale pedagogjike në mbështetje të profesioneve të rregulluara me ligj etj.

ENIO OHRI

Z. Enio Ohri shërben si analist pranë Kabinetit të Kryeministrit. Ai vjen nga një eksperiencë pune në organizatat e shoqërisë civile, ku ka shërbyer si koordinator i projekteve. Më parë, z. Ohri ka shërbyer pranë Kabinetit të Kryeministrit, si ndihmës.

Z. Ohri mban diplomat “Bachelor” dhe “Master i Shkencave” për administrim biznes nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë.

JONIDA TARAJ

Znj. Jonida Taraj shërben si analist i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës prej vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe, znj. Taraj ka ndjekur zbatimin e politikave kryesore në fushën e bujqësisë dhe kulturës.

Znj. Taraj ka eksperiencë mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Më parë ka shërbyer si Drejtuese në Drejtorinë e Zhvillimit të Shërbimeve pranë Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), për një periudhë 5-vjeçare, ku njëkohësisht ka qenë dhe Drejtuese e Njesisë për Menaxhimin e Projekteve IPA (SPO), si dhe ka drejtuar ekipin ADISA Innovation Lab. Gjithashtu ka punuar në projektin ISDA të Bankës Botërore, si konsulente lokale për ofrimin e shërbimeve. Ajo ka nisur karrierën e saj në sektorin e arsimit të lartë, ku krahas mësimdhënies, ka punuar si koordinatore e Institutit Barleti për Kërkim dhe Zhvillim, si dhe menaxhere e Qendrës së Karrierës pranë universitetit “Marin Barleti”.

Znj. Taraj mban diplomën “Master i Shkencave” nga Universiteti i Bergamos në Itali, në degën Ekonomi, Inovacion dhe Organizim të Bizneseve në Tregun Global dhe “Bachelor”, në degën e Ekonomiks dhe Biznes nga po i njëjti universitet.

MARSEL PREÇI

Z. Marsel Preçi shërben si ndihmës pranë Kabinetit të Kryeministrit. Z. Preçi vjen nga një experiencë 16 vjeçare në fushën e teknologjisë së informacionit. Më parë, z. Preçi ka shërbyer si drejtor i Sistemeve E-Gov pranë AKSHI-t, përgjegjës i sektorit të rrjetit dhe sistemeve në Drejtorinë e IT pranë Bashkisë së Tiranës, specialist IT në Bashkinë e Tiranës

Z. Marsel Preçi mban Diplomën e Integruar të Nivelit të Dytënë inxhinieri informatike nga Universiteti Politeknik i Tiranës.

DENADA MARKO

Znj. Denada Marko mban pozicionin e ndihmësit të Kryeministrit në Kabinetin e Kryeministrit prej shtatorit 2013. Ajo ka përvojë pune si specialiste pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë dhe për vite me radhë si asistente e kryetarit të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu, znj. Marko ka punuar si asistente e kryetarit të Partisë Socialiste.

Znj. Marko ka kryer studimet e larta në Universitetin e Bukureshtit, në Fakultetin e Drejtësisë, diplomuar në degën “Juridik”. Ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën e të drejtave, sigurisë kombëtare dhe atë të NATO-s etj.

EGESTA MURATAJ

Zj. Egesta Murataj shërben si ndihmëse e Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Ajo vjen nga një eksperiencë në sektorin bankar. Znj. Murataj mban diplomën “Master në Bankë & Financë” nga Universiteti King’s College London dhe diplomë “Bachelor në financë” nga University of Neë York Tirana. Gjithashtu, znj. Murataj ka kryer trajnime në Departamentin e Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë dhe trajnime në kontabilitet, në një sipërmarrje private.

SKËNDER DUKA

Z. Skënder Duka shërben si ndihmës në Kabinetin e Kryeministrit. Në këtë detyrë ai vjen nga një përvojë disa vjeçare në shoqërinë civile, si bashkëpunëtor dhe koordinator projekti. Më parë, z. Duka ka shërbyer në dy legjislatura si zëdhënës i shtypit i kryetarit të Kuvendit. Në këtë angazhim, z. Duka vinte pas një pune mbi dy dekada në shtypin periodik, për të mbërritur tek emërimi i parë, ai i kryeredaktorit të gazetës “Studenti”, organ i rinisë universitare. Ai ka punuar edhe disa vite si pedagog i jashtëm i lëndës së estetikës, në Universitetin e Tiranës.

Ai ka kryer studimet pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike të Universitetit të Tiranës, në degën e gazetarisë. Më parë ai është diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe të Universitetit të Tiranës.

Njëherësh, gjatë viteve të tij të punës, z. Duka është kualifikuar në tematika të tilla, si: "Media dhe transparenca"- Fondacioni “Friedrich Ebert”; “Marrëdhëniet me publikun dhe media”- kualifikim nga Senati Amerikan; "Praktikat Parlamentare dhe Transparenca në Media" - Zagreb, East Eest Program; "Media dhe qeverisja elektronike"- OKB, Neë York; "Media dhe informimi publik"; "E drejta e publikut për informacion dhe administrata publike".

Ai ka botuar librin me ese “Dialog i munguar” dhe është bashkëpunëtor në botimin e serisë: "Monitori shqiptar i medias". Zotëron gjuhët anglisht dhe frëngjisht.

ISEI DAKOLI

Znj. Isei Dakoli shërben si ndihmës i Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, në Zyrën Operacionale të Situatës prej vitit 2022.

Znj. Dakoli ka përfunduar studimet universitare në nivelin “Master” pranë University of Geneva në Gjenevë, Zvicër, në degën “Science of Statistics”. Gjithashtu, mban diplomën “Bachelor” nga po i njëjti universitet, në fushën e ekonomisë, me specializim në statistikë.

UENDI BELBA

Znj. Uendi Belba shërben si ndihmëse pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Më parë znj. Belba ka shërbyer në Zyrën e Protokollit të Kryeministrit, duke mbajtur korrespondencën zyrtare me Misionet e Huaja të akredituara në Shqipëri, përpiluar letrat zyrtare në kornizën e korrespondencës zyrtare protokollare të Kryeministrit, si dhe duke koordinuar takime, brenda institucionit e një sërë eventesh me partnerë shqiptarë e të huaj, në kuadër të agjendës së Kryeministrit.

Znj. Uendi Belba mban diplomën “Master i Shkencave” në “Politika dhe Qeverisja në Evropë”, pranë Institutit të Studimeve Evropiane (2023), pjesë e Universitetit të Tiranës, si dhe diplomën “Master Profesional” në “Mësuesi në Gjuhë-Letërsi për Arsimin e Mesëm” (2021), gjithashtu dhe diplomën “Bachelor” në “Gjuhë-Letërsi” (2019), të dyja pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, pjesë e Universitetit të Tiranës. Studimet e saj znj. Belba i ka përfunduar me rezultate shumë të larta dhe mban medaljet respektive.

Gjithashtu, znj. Belba ka ndjekur një sërë trajnimesh, si: “Supporting Democracy in the Eastern Balkans – Progress and Bridges II, Political Academy 2022”, organizuar nga Fondacioni Qemal Stafa me mbështetjen e Fondacionit Kalevi Sorsa (Finlandë); “EU Institutions and Policy Making”, në kuadër të programit Jean Monnet Chair, mundësuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar në Institutin e Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës (2022); “EU – China Relationship”, realizuar nga Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Evropiane, Instituti Konfuci (2021) etj.

Pjesëmarrëse dhe vlerësuar në evente, si: “Edicioni i IV i Labororit të Debatit Universitar – Nga Fjala Tek Veprimi”, realizuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (2022- 2023), “Lider për një ditë”, “Panairi i shoqërive të nxënësve”, në kuadër të programit Junior Achievement of Albania. Znj. Belba ka disa eksperiencë vullnetare në Bashkinë e Tiranës, në organizimin e “Maratonës së Tiranës”, “Tirana Art Fest” etj., për të cilat është vlerësuar me certifikatat përkatëse të eventeve, por dhe si “Vullnetari i vitit” 2016, 2017, 2018 nga Bashkia e Tiranës.

SARA XHUMBARI

Sara Xhumbari, mban pozicionin e ndihmësit të Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit, prej muajit shtator 2022.

Znj. Xhumbari ka përfunduar studimet universitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në vitin 2002. Prej vitit 2005, mban titullin "Avokat".

Më herët, znj. Xhumbari ka punuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive duke mbajtur pozicionin e Drejtorit dhe Përgjegjësit të Sektorit të Drejtorisë Juridike dhe Licencave, si dhe juriste në Ministrinë e Mbrojtjes e organe të qeverisjes vendore.

MARIELA KATRO

Znj. Mariela Katro shërben si ndihmëse pranë Kabinetit të Kryeministrit, Zyra e Protokollit të Kryeministrit. Më parë, znj. Katro ka shërbyer si redaktore gjuhësore pranë gazetës “Panorama”, redaktore pranë kompanisë “Unison Agency”, si dhe redaktore pranë shtëpisë botuese “Onufri”.

Znj. Mariela Katro mban diplomën “Post Master” në programin e studimit “Marrëdhënie ndërkombëtare” pranë “Albanian University”, si dhe diplomën për gjuhë-letërsi, specialiteti

gjuhësi, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Znj. Katro disponon certifikatën e INIMA-s dhe dëshminë e mbrojtjes së gjuhës angleze pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dhe ka marrë pjesë në trajnime në studimet politike, historike, në fushën juridike etj, pranë Akademisë Profesionale “Elita”.

MERITA SALIAJ

Znj. Merita Saliaj mban pozicionin e ndihmësit të Kryeministrit pranë Kabinetit të Kryeministrit.

Ajo vjen nga një përvojë pune disa vjeçare në Kryeministri.

Znj. Saliaj ka kryer studimet e larta në fushën e së drejtës dhe është specializuar në të drejtën civile dhe tregtare. Ajo ka kryer gjithashtu një sërë trajnimesh dhe zotëron disa kualifikime në fushën e të drejtës europiane, sigurisë kombëtare dhe antikorruptionit.